

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 819 Prot.

Tiranë, më 27.07 2016

VENDIM Nr. 91, datë 22.07.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), VKM Nr. 303 datë 20.04.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 1197, datë 3.12.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e Kalasë së Tiranës "Zonë Arkeologjike "A" dhe miratimin e Rregullores së administrimit të saj, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 10 të datës 22.07.2016, pasi shqyrtoi *Projektin përfundimtar të zbatimit "Pazari i Tiranës"*, i ndodhur në zonën arkeologjike "A" të Kalasë së Tiranës, kërkuar nga familja Toptani,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin përfundimtar të zbatimit "Pazari i Tiranës"*, i ndodhur në zonën arkeologjike "A" të Kalasë së Tiranës, kërkuar nga familja Toptani, për sa kohë nuk bie ndesh me zhvillimin e projekteve kërkimore-shkencore në fushën e arkeologjisë.
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje dy palëshe me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, i cila do të mbikëqyrë zbatimin e punimeve.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës dy palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO